



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 174 dt.10.10.1996

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur për adoptimin e kateve të para të apartamenteve të banimit

VENDOSI

1. Të miratojë përbërjen e grupit të punës që do të kontrollojë kërkesat e të interesuarve për adoptimin e kateve të para, si dhe detyrat që ka ky grup, deri në paraqitjen e materialit të reçensuar për në K.RR.T. Grupi i punës të përbëhet nga këta inxhinierë konstruktorë :

| | |
|------------------|-----------------------------------|
| 1.Haki Radheshi | pranë Drejtorisë së Urbanistikës |
| 2.Dhurata Struga | pranë I.S.T.N. Tiranë |
| 3.Lejla Pasko | pranë I.S.P.U.N. Tiranë |
| 4.Alfred Papa | pranë I.S.P.U.N. Tiranë |
| 5.Mefail Halilaj | pranë “General – Projekt” Tiranë. |
2. Të miratojë shpërblimin e inxhinierëve konstruktorë për punën e paraqitur, që nuk punojnë në Drejtorinë e Urbanistikës, në masën 5.000(pesë mijë)lekë, për çdo material të reçensuar që paraqitet në K.RR.T.
3. Materiali i reçensuar, pasi të jetë studiuar, të firmoset dhe nga urbanistët e Njësi Administrative, që kanë

paraqitur në Drejtorinë e Urbanistikës, kërkesat për
adoptimet e kateve të para nga të interesuarit e njësisë së
tyre administrative, ku bëhet adoptimi.

KRYETARI

BESNIK PETRELA